

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Kaçiku, kryetare, Nazmije Ibrahimimi dhe Erdogan Haxhibeqiri, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit KS “S.” me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim A. K., av. nga Prishtina, kundër të paditurës NTP “A. C.” me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim M. R., për kthimin e mjeteve nga fitimi i pabazë, vlera e kontestit 300.000 €, përkitazi me revizionin e paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Prishtinë, Ae.nr.444/2012, datë 9.10.2013, në seancën e mbajtur më 9.3.2016, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i pabazuar revizioni i paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Prishtinë, Ae.nr.444/2012 datë 9.10.2013.

### A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës-Prishtinë, Ae.nr.444/2012 datë 9.10.2013, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, III.C.nr.124/2012 datë 17.5.2012, me pjesën I të dispozitivit të të cilit është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit që të obligohet e paditura t’ia kthejë atij shumën prej 300.000 €, në emër të fitimit të pabazë, me kamatë ligjore dhe t’ia paguajë shpenzimet e procedurës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pasi aktgjykimi të ketë marrë formë të prerë, nën kërcënim të përmbartimit me detyrim. Me pjesën II të dispozitivit është obliguar paditësi që të paditurit, në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, t’ia paguajë shumën prej 344.76 €, në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbartimit me detyrim.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, paditësi me kohë ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që revizioni të aprovohet si i bazuar dhe aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta të prishen, kurse çështja t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

E paditura ka paraqitur përgjigje ndaj revizionit, me propozimin që ky të hidhet poshtë si i pasafatshëm ose të refuzohet si i pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin III.C.nr.124/2012, datë 17.4.2014, e ka hedhur poshtë revizionin si të pasafatshëm, ndërsa Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin Ae.nr.164/2014, datë 20.1.2016, e ka anuluar aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 215 të LPK, konstatoi:

Revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se paditësi dhe e paditura kanë qenë në marrëdhënie kontraktuese në bazë të policës së sigurimit nr. ..., për një periudhë sigurimi nga data 3.4.2007 deri më 2.4.2008, mbi bazën e sigurimit të pronës nga zjarri dhe rreziqet shtesë, për depon në fshatin ..., Prishtinë, në vlerë prej 100.000,00 € dhe mallit tregtar në vlerë prej 500.000,00 €, në vlerë totale prej 600.000,00 €. Në datën 27.4.2007, në depon e përmendur kishte rënë një zjarr, për të cilin me kohë ishte njoftuar paditësi. E paditura më 7.5.2007 ka paraqitur kërkesë për kompensimin e dëmit, ndërsa më 13.6.2007 palët ndërgjyqëse kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore për kompensimin e dëmit në shumën prej 486.323,06 €. Me urdhërpagesën e datës 6.7.2007 është paguar shuma prej 299.668,80 €, ndërsa me urdhërpagesën e datës 7.7.2007 është paguar shuma prej 150.000,00 €.

Paditësi ka kërkuar me padi kthimin e mjeteve nga fitimi i pabazë, në shumën prej 300.000,00 €.

Nisur nga kjo gjendje faktike e vërtetuar, gjykata e shkallës së parë ka konsideruar se pretendimi i paditësit për kthimin nga e paditura të mjeteve nga fitimi i pabazë nuk qëndron, ngase, sipas dispozitës së nenit 211 të LMD, për ushtrimin e kërkesës për pasurim të pabazë duhet të përmbushen kushtet ligjore, që përfshijnë jo vetëm arritjen e fitimit në njërin anë dhe dëmtimi në anën tjetër, por edhe mosekzistimin e kauzës në të cilën do të mbështetej arritja e fitimit pa kompensim.

Gjykata e shkallës së dytë, në procedurën e zhvilluar me rastin e ankesës, i ka aprovuar në tërësi gjetjet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, duke refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit dhe duke vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, nisur nga një gjendje e tillë e çështjes, ka gjetur se gjykatat e instancave më të ulëta, duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, i kanë zbatuar drejt dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadija e paditësit është e pabazuar.

Pretendimin e paditësit të ngritur në revizion, sipas të cilit aktgjykimi i kundërshtuar është i paqartë, sepse me këtë aktgjykim nuk mund të konstatohet baza e refuzimit të kërkesëpadiisë, Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi si të pabazuar, ngase në aktgjykimet e atyre gjykatave është vërtetuar fakti se palët ndërgjyqëse, në datë 13.6.2007 kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore për kompensimin e dëmit, e cila është nënshkruar pa vërejtje, pa presion d.m.th. me vullnet të palëve ndërgjyqëse, prandaj janë zbatuar drejt dispozitat ligjore të parashikuara nga neni 210 dhe 211 kur kanë vendosur si në dispozitiv të aktgjykimeve të kundërshtuara.

Gjykata Supreme e Kosovës e shqyrtoi pretendimin e ngritur në revizion se baza e kërkesëpadiisë kishte të bënte me vërtetimin e faktit nëse ditën e rënies së zjarrit, malli i

paraqitur kishte qenë ose jo i vendosur (në përmbajtje dhe sasi) në depo, por konstatoi se me këtë pretendim nuk vihet në dyshim ligjshmëria e aktgjykimit të kundërshtuar, ngase paditësi, në asnjë fazë të procedurës, nuk e ka kontestuar faktin se me të paditurën kishte arritur marrëveshje jashtëgjyqësore për kompensimin e dëmit, ndërsa kjo Gjykatë shton se, sipas nenit 26 të LMD, kontrata quhet e lidhur kur palët të jenë marrë vesh për elementet thelbësore të saj.

Gjykatat e instancave më të ulëta me të drejtë kanë vlerësuar se palët ndërgjyqëse, me vullnetin e lirë të tyre, kanë nënshkruar kontratën, e cila është përmbushur me rastin e pagimit të shumës së përmendur dhe, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, është zbatuar drejt neni 211 i LMD-së, prandaj pretendimet e ngritura në revizion lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, u vlerësuan si të pabazuara.

Për sa i përket pretendimit se gjykata e shkallës së parë pa të drejtë ka refuzuar propozimin e paditësit që të caktohet eksperti i aktuaristikës për t'u vërtetuar gjendja faktike, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se, sipas nenit 214 par. 2 të LPK, revizioni nuk mund të paraqitet për vërtetim jo të plotë e të gabuar të gjendjes faktike.

Gjykata Supreme e Kosovës aktgjykimin e kundërshtuar e shqyrton në përputhje me dispozitën e parashikuar nga neni 215 i LPK vetëm në pjesën e tij të goditur me anë të revizionit dhe vetëm brenda kufijve të shkaqeve të vëna në dukje në revizion, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatim të drejtë të së drejtës materiale dhe duke i vënë re shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore që kanë të bëjnë me zotësinë për të qenë palë dhe me përfaqësimin e rregullt.

Nga sa u tha më lart dhe me zbatimin e nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË  
E.Rev.nr.9/2016 datë 9.3.2016

Kryetare e kolegjit,  
Emine Kaçiku